


01-1780



Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-234635/22 dt. 26.10.2022, të pronarëve Luan Hoxha, Armend Hoxha dhe Ramadan Ukiq nga Prishtina dhe investitorit “Delta Invest” sh.p.k. me seli në Prishtinë, rruga “Nëna Terezë”, nr. 114, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, ndërtuar në kuadër të bllokut urbanistik “T-23”, të Planit Rregullues “Tophane”, në rrugën “Mark Isaku” në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 01.07.2024, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LEJOHET pronarëve Luan Hoxha, Armend Hoxha nga Prishtina me investitor “Delta Invest” sh.p.k. me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit ARBK 811255901, me përfaqësues Lorik Xhaferi, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-234635/22 dt. 26.10.2022, përdorimi i ndërtesës shumëbanesore me afarizëm, me etazhitet B+P+6ET, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-155630/18 dt. 01.04.2019 dhe Vendimit 05 Nr. 351/02-155630/18/1 dt. 22.10.2021 mbi plotësim ndryshimin e projektit kryesor, në kuadër të bllokut urban “T-23”, të Planit Rregullues “Tophane” së në Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 10222-0, ZK Prishtinë.

II. Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Mark Isaku” ku ka dalje hyrjet e kësaj ndërtese me numrat: 20, 22 dhe 24 në Prishtinë, dhe e njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.

III. Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës dhe njësive të saja në evidencat e regjistrit kadastral.

IV. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronarët Luan Hoxha, Armend Hoxha nga Prishtina dhe investitori “Delta Invest” sh.p.k. me seli në Prishtinë, rruga “Nëna Terezë”, nr. 114, me certifikatë të regjistrimit ARBK 811255901, me përfaqësues Lorik Xhaferi, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-234635/22 dt. 26.10.2022, i janë drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shumë banesore me afarizëm, me etazhitet

B+P+6ET, të ndërtuar në kuadër të bllokut urban "T-23", të Planit Rregullues "Tophane", në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale nr. 10222-0, ZK Prishtinë, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore Ndërtimore 05 Nr. 351/02-155630/18 dt. 01.04.2019 dhe Vendimit 05 Nr. 351/02-155630/18/1 dt. 22.10.2021 mbi plotësim ndryshimin e projektit kryesor, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare "Akt përcjellës", me referencë 09 Nr. 391/02-13223/22 dt. 15.02.2023, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizimit, Raportet e Njoftimin mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuetit kanë prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të e Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukturore-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Rexhep Saliu, Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Rexhep Saliu; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Bukurie Berisha; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Ismet Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve makinerike, nga mbikëqyrësi Shukri Krasniqi; Raportin e përfundimit të punëve për mbrojtje nga zjarri, nga Arban Shala, Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar Xhavit Fetahu të licencës 75;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Bazuar aktin noterial "Kontratë për dhënie të banesës së vjetër me kompensim për banesë të re" me numër LRP 4696/2018, Ref.475, poseduesi, Ramadan Ukiq, i ndërtesës me destinim banim individual me numër të njësisë kadastrale O-71914059-04818-0-1280-2 e ndërtuar në kuadër të parcelës me nr. 4818-0, ZK Prishtinë në pronësi/posedim P.SH.-KK Prishtinë. Parcelë kjo e cila është këmbyer me një pjesë të parcelës 4822-0 ZK. Prishtinë, në pronësi të bashkë pronarëve Luan dhe Armend Hoxha sipas pëlqimit me paraprak me numër 05Nr.464/03-286112/18 të datës 06.12.2018 të lëshuar nga kjo Drejtori.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shumë banesore me afarizëm mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesat shumë banesore me afarizëm.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesve/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS
05 NR. 391/02-234635/22 DT. 01.07.2024

Zyrtari,
Berim Osmanaj



